



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 19, datë 28.12.2022

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT
NR.32, DATË 28.12.2020 "PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
"GREEN COAST RESORT 2", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërinë "Green Coast" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 32, datë 28.12.2020 "Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: "Green Coast Resort 2", me vendndodhje Bashkia Himarë, pika 1 zëvendësohet si më poshtë vijon:
"Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Green Coast Resort 2", me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me zhvillues "Green Coast" sh.p.k., "Aquamarin" sh.p.k., "I & G" sh.p.k., "Devis Construction" sh.p.k., "Edonil Konstruksion" sh.p.k., "Shamo Construction" sh.p.k., "Klais" sh.p.k., "Seaside Hospitallity" sh.p.k., "Seaside Hotel" sh.p.k., "Seaside Hotel II" sh.p.k., "Seaside Entertainment" sh.p.k., "Seaside Residence I" sh.p.k., "Seaside Residence II" sh.p.k., "Seaside Residence III" sh.p.k., "Seaside Residence IV" sh.p.k., "Seaside Residence V" sh.p.k."
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë që përmenden në pikën 2, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 32, datë 28.12.2020 "Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin "Green Coast Resort 2", me vendndodhje në Bashkinë Himarë, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Procedurat administrative/ligjore për të gjitha zonat, të cilat nuk janë pajisur ende me dokumentin e lejes së ndërtimit, sikurse evidentohen në Hartën e Planvendosjes së Strukturave, bashkëlidhur këtij Vendimi, do të vijohen nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit.
4. Marrëveshja përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 32, datë 28.12.2020 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI
EDIRAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/05 2024